

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti I Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Ramiz Azizi, me zyrtarën ligjore Florentina Ademi në lëndën penale ndaj të akuzuarit R.H. nga ..., për shkak të veprës penale lëndim i lehte trupor nga neni 188 paragraf 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi 1.4 dhe neni 31 të KPRK-së, te cilin sipas autorizimi e mbron av. S.R. nga ..., sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr:76/2018 të datës 31.01.2018, të cilën e përfaqëson prokurori i shtetit Shefik Memeti pas mbajtjes së seances fillestare dhe publike, si dhe sipas marveshjes me shkrim të dt.02.02.2018, më datën 06.02.2018, në prezencë të palëve komunikon këtë :

A K T G J Y K I M

I akuzuari **R.H.** nga i ati, S., dhe nëna Xh., e lindur, R., i lindur me date ... në ..., tani jeton ku edhe jeton rruga “ .. ” nr:... në ..., i martuar, baba i dy fëmijëve ka të kryer shkollen mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, më pare I pa dënuar e as nën hetime.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse

Me datë 15.01.2018, rreth orës 15:00 minuta, në ... në shtëpine e tyre të përbashkët familjare në rr.” ... ” nr: ..., për shkak të mos marrëvshjeve të pa ndërprera dhe të vazhdueshme fizike dhe psikike në familje, i pandehuri R.H. në bashkëveprim me të miturin R.H lëndon lehtë bnashkëshorten e vet, tani të dëmtuarën Z.H., në atë mënyrë që i pandehuri posa kthehet në shtëpi dhe e kupton se bashkëshortja e tij kishte ndërhyrë për t'i ndarë fëmijët e tyre të cilët ishin kacafytur mes vete, menjëher pa asnjë pretekst e godet të dëmtuarën me grushte në kokë, në syrin e majtë dhe në pjesë të ndryshme të trupit duke i shkaktuar të dëmtuarës, lëndime të lehta trupore, e cila për shkak të lëndimeve të pësuar detyrohet të kërkojë ndihmë mjekësore në Emergjencën e Spitalit Regjional në Gjilan.

-me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, lidhur me paragrafin 4 dhe nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, bazuar në nenin e lartë cekur si dhe në nenet, 4, 7, 17, 21, 41, 49, 50, 51, 73 dhe 83 të KPRK-së si dhe të neneve 233, 365, 451 të KPPRK-ës atij i shqipton

DENIM ME KUSHT

*I. Të akuzuarit **R.H.** i caktohet dënimi me burgim me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një viti), dënimi i cili nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri në afat verifikues prej dy viteve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i plotfuqishëm nuk kryen veprë të kësaj natyre ose ndonjë veprë tjetër penale, në të kundërtën vendimi për dënimin e shqiptuar, ka për t'u revokuar ashtu që i pandehuri ka për ta vuajtur dënimin e lartë shënuar me burgim efektiv.*

II. Obligohet i pandehuri që në pajtim me nenin 39 paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në emër të taksës për kompensim të viktimave të paguaj taksë në shumë prej 30 Euro.

III. Obligohet i pandehuri që të dëmtuarës t'ia kthejë aparatën celularë me SIM kartelë dhe me mbushje prej 5€.

IV. E dëmtuara në seancë gjyqësore ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate si dhe paushallin gjyqësor në lartësi prej 25 euro, (njëzetë e pesë) Euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.76/2018 të datës 31.01.2018 kundër të akuzuarit R.H. nga Gjilani për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafin 1.4 të KPRK-së. Asnjëra palë nuk e kundërshtoi gjyqtarin e vetëm gjykues, nuk pati asnjë vërejtje ndaj të njëjtit.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë si dhe të sanksionit penal i është paraqitur gjyqtarit të vetëm gjykues konform nenit 233 të KPPRK-së më datën 02.02.2018, e cila si e tëra është edhe pjesë përbërëse e kësaj lënde penale.

Për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafin 1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, paraqitet dënimi me kusht në kohëzgjatje prej 1 (një) viti i cili nuk do të ekzekutohet në periudhë prej 2 (dy) viteve nëse i pandeuri nuk kryen veprë të tilla ose ndonjë veprë tjetër penale.

Përfaqësuesi i aktakuzës, prokurori i shtetit Shefik Memeti e ka njoftuar gjyqtarin e vetëm gjykues për dhënjen e pëlqimit me shkrim nga e kryeprokurorit dhe për lidhjen e marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe sanksionit penal, duke hequr dorë nga dëgjimi i dëshmitarëve të propozuar si dhe të shtjellimit të provave të tjera materiale.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.H., avokati S.R. nga ..., e ka njoftuar gjyqtarin e vetëm gjykues për marrëveshjen në fjalë të lidhur me përfaqësuesin e akuzës në prezencën e të akuzuarit, duke hequr dorë nga dëgjimi i dëshmitarëve dhe të shtjellimit të provave tjera, dhe që dënimi i paraparë me marrëveshjen për pranimin e fajësisë të pranohet nga gjykata.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal për të akuzuarin R.H., i përmban të gjitha kushtet, duke bërë propozim për marrëveshjen e pranimit të fajësisë dhe sanksionimit penal, e bërë në mënyrë vullnetare, duke deklaruar edhe për arsyet e pranimit të fajësisë si dhe të sanksionit penal.

Gjykata ka gjetur se palët procedurale marrëveshjen në fjalë e kanë bërë konform dispozitës ligjore të nenit 233 të KPPRK-së.

Gjykata është e bindur se i akuzuari R.H. nga ..., e ka kryer veprën penale me dashje, si dhe ka konstatuar se nuk ekziston asnjë diskualifikim i cekur nga neni 233 të KPPRK-së.

Pasi që palët procedurale, prokurori i shtetit i akuzuari dhe mbrojtësi i tij kanë arritur marrëveshje mbi pranimin e fajësisë dhe të sanksionit penal, gjykata atë e mori dhe e pranoi pa kurrfarë hezitimi si të arritur me vullnet nga palët procedurale.

E dëmtuara Z.H. nga ... nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të akuzuarit, gjyqtari i vetëm gjykues mori për bazë marrëveshjen mbi pranimin vullnetar të fajsisë dhe të sanksionit penal nga i akuzuari R.H., si dhe rrethanat tjera lehtësuese si sjelljen korrekte në gjykatë, pendimin për atë qka kishte bërë në afekt, premtimin se një gjë të tillë unë kurrë nuk do ta përsërisë, e si rrethana rënduese gjeti: pasojat që ia ka shkaktuar viktimës.

Gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar me kusht ndaj të akuzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, si dhe me rrezikshmërinë shoqërore, kështu që me këtë dënim do të mund të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me neni 41 të KPRK-së.

Përfaqësuesi i aktakuzës, i dëmtuari dhe mbrojtësi i tij deklaruan se heqin dorë nga ankesa.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 451, të KPPRK-së.

Nga të cekurat e theksuara më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
P.nr. 126/18 të datës 06.02.2018

Zyrtarja Ligjore

Florentina Ademi

Gjykatësi

Ramiz Azizi

KËSHILLA JURIDIKE *Palët procedural kanë hequr dorë nga ankesa e këtij aktgjykim, andaj i njejtë nuk mundë të akimohet dhe bëhet menjëherë I formës së prerë.*

